

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Pas urdhrit të arbitrazhit, Pacolli i bën THIRRJE publike qeverisë: Krijë kushtet për dialog, ne nuk e doni m këtë! Dëshira jonë, përfundimi i aeroportit
ADRESA	https://newsbomb.al/aktualitet/pas-urdhrit-te-arbitrazhit-behgjet-pacolli-i-ben-thirrje-publike-qeve-i401456
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 13:07:29 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 12:59:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5796dd6edf8cc20cf24c5d243b30a17b3f1a7b21cf2660d9be8cd63362538d5b
TEKSTI	3fbcc02c587110e927b48c620551924d01818bf966febea2e8d10fa4eca11aa2
PAMJA	2b652d249fb044f937487f168ffed7d5bccdcee6b5422139f1059feca8067bd4

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	49f2f7b7342dacd118b2b3d3f005d27cd39321c0c37ce9715ec986136106ee54
E MËPARSHMJA	229bdc7575ba88d586a4815108b49c6a8ca0483325069a94c25d9ad8e58f7d6e
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahëso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/49f2f7b7342dacd118b2b3d3f005d27cd39321c0c37ce9715ec986136106ee54>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista

Kreu Politikë Aktualitet Ekonomi Kulturë & Art Rajon Sport Bota Showbiz SocialBomb



Çështjet kryesore

Haga vendos për katër ish-krerët e UÇK-së!

Arrestohet Ergys Agasi

"Retreat"-i i qeverisë në Pogradec!

Aktualitet

17 Shtator 2026, 14:59

Pas urdhrit të arbitrazhit, Pacolli i bën THIRRJE publike qeverisë: Krijo kushtet për dialog, ne nuk e donim këtë! Dëshira jonë, përfundimi i aeroportit



Shkruar nga Newsbomb



Ilustrim: Behgjet Pacolli dhe aeroporti i Vlorës

Miliarderi shqiptar nga Kosova, Behgjet Pacolli, përmes një postimi në llogarinë e tij në rrjetin social "Facebook" ka bërë një apel publik për qeverinë e Shqipërisë.

Përmes një statusi biznesmeni i ka bërë thirrje qeverisë të rishqyrtojë qëndrimin e saj dhe të krijojë kushtet për një dialog institucional dhe konstruktiv. Ky reagim i Pacollit vjen pas vendimit të qeverisë, të cilin ai e konsideron të njëanshëm, për të bërë ndërprerjen e kontratës së koncesionit të Aeroportit të Vlorës, gjë kjo e cila solli "detyrimin" e MABCO-s që t'i drejtohej arbitrazhit ndërkombëtar.

"Më 16 shtator 2026, arbitra e emergjencës e ICC-së, në kuadër të procedurës me seli në Londër, nxori një urdhër paraprak që i kërkon Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të përmbahet, gjatë procedurës së emergjencës, nga çdo veprim lidhur me ndërprerjen e koncesionit që mund të përkeqësojë mosmarrëveshjen ose të cenojë këtë procedurë. Ky urdhër duhet respektuar", shkruan Pacolli.

Teksa më tej në shkrimin e tij thekson se nuk është synuar që në fillim zgjidhja e çështjes përmes arbitrazhit, por përkundrazi kanë kërkuar zhvillimin e bisedimeve dhe arritjen e një marrëveshjeje që do të mundësonte vazhdimin e punimeve dhe përfundimin e aeroportit.

Revista



Abonohu tani dhe lexoje >

Lajmet e fundit



Sporti

Ngjarje e rëndë! Portieri kërcënohet me vdekje para ndeshjes, reagim i "rrefeshëm" nga trajneri



Politikë

Taulant Balla publikon VIDEO! Dje i jepte meritat për luftën, kur Sali Berisha "nxinte" Hashim Thaçin: Argat i serbëve! Vrau 200 anëtarë të LDK-së

Zbulu më shumë artikuj >

"I bëj thirrje Qeverisë edhe një herë të zgjedhë dialogun dhe një zgjidhje të dakordësuar. Përfundimi i kësaj vepre dhe vënia e saj në shërbim të qytetarëve, turizmit dhe ekonomisë shqiptare do të ishte në interes të publikut dhe do të shmangte shpenzime të konsiderueshme për procedura ligjore.", tha ai duke ritheksuar se: "MABCO nuk don arbitrazhin. MABCO synon përfundimin e Aeroportit të Vlorës.

Qëllimi ynë është të përfundojmë këtë vepër të rëndësishme infrastrukturore dhe t'ia dorëzojmë Shqipërisë si një aset me vlerë, që do t'u shërbejë qytetarëve dhe brezave të ardhshme. Ne nuk kërkojmë konflikt, nuk kërkojmë favore por kërkojmë të përfundojmë atë që kemi nisur sikurse kemi bërë në gjithë Botën.

Pavarësisht rrethanave, lidhja ime me Shqipërinë dhe përkatësia ime ndaj këtij vendi mbeten të pandryshuara."

Këshilluar për ty



"Zgjidhja e Kontratës së Koncesionit ka hyrë në fuqi", shteti shqiptar pas urdhrit të nxjerrë nga Arbitri i Emergjencës: Do ta njoftojmë sot Aeroportin e Vlorës (REAGIMI I MIE)

Postimi i plotë:

APEL PUBLIK PËR QEVERINË E SHQIPËRISË

Pas vendimit të njëanshëm të Qeverisë për ndërprerjen e kontratës së koncesionit për Aeroportin e Vlorës, MABCO, investitori dhe financuesi i këtij projekti, si dhe zotëruesi i 98% të kuotave të VIA-s, u detyrua, në përputhje me kushtet kontraktuale, t'i drejtohej arbitrazhit ndërkombëtar për mbrojtjen e të drejtave dhe investimit të saj.

Më 16 shtator 2026, arbitra e emergjencës e ICC-së, në kuadër të procedurës me seli në Londër, nxori një urdhër paraprak që i kërkon Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të përmbahet, gjatë procedurës së emergjencës, nga çdo veprim lidhur me ndërprerjen e koncesionit që mund të përkeqësojë mosmarrëveshjen ose të cenojë këtë procedurë. Ky urdhër duhet respektuar.

I bëj thirrje Qeverisë që të rishqyrtojë qëndrimin e saj dhe të krijojë kushtet për një dialog institucional dhe konstruktiv.


MABCO NUK KA SYNUAR zgjidhjen e kësaj çështjeje përmes ARBITRAZHIT. Përmes më shumë shpresave, tentativave për takim, thirrjeve për veprime konstruktive dhe shmanjen e pëngesave, kemi kërkuar vazhdimisht zhvillimin e bisedimeve dhe arritjen e një marrëveshjeje civilizuese që do të mundësonte vazhdimin e punimeve dhe përfundimin e aeroportit.

Propozimi ynë mbetet i qartë: të na mundësohet përfundimi i aeroportit dhe vënia e tij në funksion.

Në këtë fazë, kërkojmë që në VIA të këthehet legjitimiteti, puna dhe investimi ynë të respektohen dhe që procesi i përfundimit të aeroportit të vijojë.

I bëj thirrje Qeverisë edhe një herë të zgjedhë dialogun dhe një zgjidhje të dakordësuar. Përfundimi i kësaj vepre dhe vënia e saj në shërbim të qytetarëve, turizmit dhe ekonomisë shqiptare do të ishte në interes të publikut dhe do të shmangte shpenzime të konsiderueshme për procedura ligjore.

Behgjet Pacolli





APEL PUBLIK PËR QEVERINË E SHQIPËRISE

Pas vendimit të njëanshëm të Qeverisë për ndërprerjen e kontratës së koncesionit për Aeroportin e Vlorës, MABCO, investitori dhe financuesi i këtij projekti, si dhe zotëruesi i 98% të kuotave të VIA-s, u detyrua, në përputhje me kushtet kontraktuale, t'i drejtohej arbitrazhit ndërkombëtar për mbrojtjen e të drejtave dhe investimit të saj.

Më 16 shtator 2026, arbitra e emergjencës e ICC-së, në kuadër të procedurës me seli në Londër, nxori ... Shiko më shumë

1,4 mijë 147 8

Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu



E Enjte 17:05

Organizatorët përplasen me njëri-tjetrin, gazetarja: Protesta është siç e do Rama! Aktivisti: Kërkove përshkallëzim, ndërkohë vetë nuk vjen se s'e lë punën



Aktualitet

U fut për t'u larë në det por zemra e tradhëtoi, ndërron jetë pushuesi në Vellipojë

E Enjte 16:33



Aktualitet

Zegjine Çausi i nxori foton me lule dhe e lumtur krah dajës së saj, Merta Gremaj tregon si qëndron e vërteta: Kurrën e kurrës, ai më kërcënoi...

E Enjte 16:18



🕒 E Enjte 16:15

“Zgjidhja e Kontratës së Koncesionit ka hyrë në fuqi”, shteti shqiptar pas urdhrit të nxjerrë nga Arbitri i Emergjencës: Do ta njoftojmë sot Aeroportin e Vlorës (REAGIMI I MIE)



Aktualitet

Theu masën e sigurisë dhe kreu 16 vjedhje në kryeqytet, arrestohet “skifteri” 34-vjeçar (VIDEO)

🕒 E Enjte 15:46



Aktualitet

ILD “vërejtje” gjyqtarës në Berat, i përlogariti gabim dënimin një shtetasi

🕒 E Enjte 15:20



🕒 E Enjte 15:01

Falsifikuan dokumentet për ndryshimin e emrit, pezullohen nga detyra dy zyrtarë në Tiranë! Shpallet në kërkim një 41-vjeçar





Aktualitet

"5 Maji" zonë e re për zhvillim, cilat janë njësitë zbatuese të përcaktuara me VKM për rindërtim

🕒 E Enjte 14:40



Aktualitet

Dha alarm se në shkollën në Tiranë kishte bombë, protestuesi e thotë para gjykatësit: Do e bëj sërish; Gjykata vendos ta lërë të lirë

🕒 E Enjte 14:09



Aktualitet

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.